



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"  
BORDI DREJTUES

Q.S.U.T "NËNË TEREZA"  
Nr. 125/15 Prot.  
Datë, më 14.04.2025

VENDIM

NR. 3 DATË 14.04.2025

Në zbatim të VKM-së Nr. 66, datë 03.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare", Urdhërit të Përbashkët nr.709, datë 10.10.2018 "Për miratimin e Statutit të QSU "Nënë Tereza" të Ministrit Përgjegjës për Shëndetësinë dhe Ministrit Përgjegjës për Arsimin dhe VKM nr. 15 datë 09.01.2025, për "Financimin e Shërbimeve Spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025" si dhe procesverbalit nr. 125/14 prot, datë 14.04.2025 të Mbledhjes së Bordit

VENDOSI:

1. Miratimin e Draft Akt-Marrëveshje për ofrimin e shërbimit mjek roje 24 orë, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur këtij Vendimi
2. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren Bazë të Funkcionimit të QSU "Nënë Tereza", në lidhje me detyrat funksionale të punonjësve në Sektorin e Pagave pranë Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur këtij Vendimi
3. Të miratojë ndryshimet në strukturën administrative të QSU "Nënë Tereza" sipas Aneksit 3, bashkëlidhur këtij Vendimi, me një numër total prej 3049 punonjës.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT

Albana KOÇIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2025

**Akt – Marrëveshje**  
**Për ofrimin e shërbimit roje 24 orë**

E lidhur sot më datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2025, ndërmjet palëve, **Q.S.U. "Nënë Tereza" Tiranë**, Adresa, Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z./Znj. \_\_\_\_\_,

dhe

në cilësinë e **Ofruesit të shërbimit (Mjekut)** Znj.Z. \_\_\_\_\_, e bija/i biri i/e \_\_\_\_\_-it, i/e datëlindjes \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_., madhor/e dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr. ID – \_\_\_\_\_, Nr. Kontakti \_\_\_\_\_ pranë **Shërbimit të \_\_\_\_\_ të Polit të Administrimit të Integruar të \_\_\_\_\_** në Q.S.U. "Nënë Tereza" Tiranë.

**Përkufizime**

Me "*Ofrues shërbimi*" (Mjek), këtu dhe më poshtë do të kuptohet punonjës i vetëm për mbulimin e shërbimit roje 24 orë, që për nevoja të shërbimit shëndetësor, përzgjidhet nga shefi i shërbimit, kryen funksione spitalore, ushtron aktivitetin e tij në fushën diagnostike, terapeutike në shërbimin ku bën pjesë.

Me "*Përfitues shërbimi*" këtu dhe më poshtë do të kuptohet, Q.S.U "Nënë Tereza" Tiranë.

Me "*shërbim*" do të kuptohet aktiviteti i tij në fushën diagnostike spitalore, terapeutike në shërbimin ku bën pjesë i ofruar në institucionet shëndetësore universitare të nivelit terciar nëpërmjet kryerjes vetëm të shërbimit roje me sistem 24 orë.

Me “*Periudhë të pagueshme*” për lehtësi përlllogaritje do të kuptohet numri i shërbimit roje me sistem 24 orë të kryer në 1 (një) muaj, të konfirmuara nga strukturat mjekësore dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

### **1. Objekti i akt-marrëveshjes**

Kjo akt-marrëveshje ndërmjet Ofruesit të shërbimit (mjekut) dhe Q.S.U. “*Nënë Tereza*”, rregullon marrëdhëniet juridike dhe financiare dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Ofruesi i shërbimit (mjeku), merr përsipër të ofrojë shërbimin e vet për një periudhë të caktuar kohe në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të Q.S.U. “*Nënë Tereza*”, e cila merr përsipër të paguajë një shpërblim. Ofruesi i shërbimit (mjeku) lidh marrëdhëniet juridike me Q.S.U. “*Nënë Tereza*” bazuar në procedurën e miratuar nga Bordi Drejtues i QSU “*Nënë Tereza*” dhe është nën kujdesin e Shefit të Shërbimit, që ka përgjegjësi ligjore për çdo akt e procedurë që ofruesi i shërbimit (mjeku) kryen.

### **2. Baza Ligjore**

Kjo akt-marrëveshje është hartuar, dhe bazohet në Ligjin nr. 7961 prot., datë 12.07.1995 “*Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Urdhrin e Përbashkët nr. 709, datë 10.10.2018 “*Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*” Tiranë të Ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe Ministrit përgjegjës për arsimin, Vendimin nr. 7, datë 21.09.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Q.S.U.T*” të Bordit Drejtues të Spitaleve Universitare, i ndryshuar, në Kodin Etik për punonjësit e QSUT, Vendim nr. 72, datë 08.02.2023 “*Për miratimin e rregullores së autonomisë spitalore*” Kreu III “*Fushëveprimi dhe fushat e autonomisë që i jepen spitalit publik*”, pika 2 “*Karta e autonomisë menaxheriale përcakton fushëveprimin e autonomisë në lidhje me:*”, gërma a) “*organizimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore*”, Vendim nr. 424, datë 26.6.2024 “*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit*”, Vendim nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ të Bordit Drejtues të QSU “*Nënë Tereza*” për miratimin e procedurës së ofrimit të shërbimit 24 orësh (në rast miratimi nga Bordi Drejtues), si dhe në vijim të miratimit të shefit të shërbimit me shkresë nr. \_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_, me qëllim mbulimin e shërbimit të mjekut roje 24-orësh.

### **3. Kohëzgjatja Akt – Marrëveshjes**

Kjo akt-marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme për periudhën, nga data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ deri më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .

Kjo akt-marrëveshje, ndërpritet në përfundim të afatit të parashikuar ose përpara këtij afati me Vendim të Drejtorisë si dhe me kërkesë të vetë Ofruesit të shërbimit (mjekut), duke respektuar një afat njoftimi prej 2 (dy) javësh.

#### 4. Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Ofruesi i shërbimit pranë Shërbimit të \_\_\_\_\_ të Polit të Administrimit të Integruar të \_\_\_\_\_ në Q.S.U. "Nënë Tereza", ka këto detyra:

- a. Zbaton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.
- b. Zbaton "Rregulloren Bazë të Funkcionimit të QSU "Nënë Tereza", Kodin e Etikës për punonjësit e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" si dhe Rregulloren e Brendshme të Shërbimit Mjekësor.
- c. I nënshtrohet zbatimit të gjithë akteve ligjore dhe administrative në fuqi.
- d. Respekton urdhërat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të përfituesit të shërbimit.
- e. Të jetë anëtar i Urdhërit të Mjekut gjatë periudhës së ushtrimit të profesionit në QSU "Nënë Tereza", në rast të kundërt mban përgjegjësi ligjore dhe administrative.
- f. Ka të drejtën e pagesës për shërbimin roje që kryen me miratimin e shefit të shërbimit.
- g. Nuk është pjesë e organikës së shërbimit. Ai është nën kujdesin e Shefit të Shërbimit, që ka përgjegjësi ligjore për çdo akt e procedurë që ofruesi i shërbimit kryen.
- h. Ka të drejtë të marrë pjesë në të gjithë aktivitetin e shërbimit si mbledhjet e shërbimit në mëngjes, diskutime dosjesh, mbulimin e shërbimit 24-orësh etj.
- i. Për të gjitha rastet që ndjek në shërbimin 24 orësh, ofruesi i shërbimit (mjeku) njofton dhe konfirmon ecurinë dhe mbarëvajtjen mjekësore të pacientit në çdo kohë tek Shefi i Shërbimit.

#### Q.S.U. "Nënë Tereza" :

- a. Pagan shpërblimin për ofrimin e shërbimit, 1 (një) herë në muaj, në varësi të numrit të shërbimit roje që kryen përgjatë kësaj periudhe, sipas Vendim nr. 424, datë 26.6.2024 "*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit*" si dhe zbrit nga shpërblimi, tatimin mbi të ardhurën, sipas Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar.
- b. Respekton dhe mbron në raportet e punës personalitetin e ofruesit të shërbimit (mjeku).
- c. Detyrohet të kujdeset për higjenën e vëndeve të punës dhe të marrë të gjitha masat mbrojtëse kundër rreziqeve të ndryshme.

#### 5. Parashikime pëfundimtare

- a. Kushtet e kësaj akt – marrëveshje, konsiderohen si të pranuar pa pretendime nga Ofruesi i shërbimit (mjeku) dhe kjo akt-marrëveshje merr fuqi të plotë ligjore pas firmosjes nga Titullari i Institucionit.
- b. Të gjitha çështjet e tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë akt-marrëveshje, do të rregullohen konform dispozitave përkatëse ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- c. Kjo akt-marrëveshje u hartua në tre ekzemplarë dhe u firmos nga palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

OFRUESI I SHËRBIMIT

Z.Znj. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Konceptoi: \_\_\_\_\_, Specialist SMBNJ

Pranoi: \_\_\_\_\_, Përgjegjës SMBNJ

Miratoi: \_\_\_\_\_, Drejtor DBNJ

Nr. i kopjeve: 3 (tre)

**ANEKS 2 - Ndryshimet në Rregulloren Bazë të Funksionimit, në lidhje me detyrat funksionale të punonjësve në Sektorin e Pagave pranë Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar**

Pozicioni: Përgjegjës Sektori (në Sektorin e Pagave)

Përshkrimi i Përgjithshëm i Pozicionit

**ISHTE**

Përgjegjësi i Sektorit të Pagave është në varësi të Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar dhe drejton e kontrollon punën e sektorit në funksion të përlogaritjes së pagave dhe nxjerrjes së listë-pagesave të punonjësve të QSUT në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

**BËHET**

Përgjegjësi i Sektorit të Pagave është në varësi të Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar dhe drejton e kontrollon punën e sektorit në funksion të përlogaritjes së pagave dhe nxjerrjes së listë-pagesave të punonjësve të QSUT në përputhje të plotë të elementëve të përcaktuar në aktet administrative/informacionin shkresorë (pozicion pune, nivel arsimor, tituj, vjetërsi pune etj) dhe me legjislacionin në fuqi.

Në zërin "Përgjegjësitë kryesore", poshtë pikës 3, të shtohet pika:

- ✓ Kontrollon në mënyrë të detajuar, lidhjen/pikën e pagës, të zbardhur nga specialistët e sektorit.

Pozicioni: Specialist (në Sektorin e Pagave)

Në zërin "Përgjegjësitë e veçanta të specialistëve", poshtë pikës 1, të shtohet pika:

- ✓ Në vijim të vendimeve/akteve të përcjella nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në të cilën citohet pozicioni, vendi i punës (njësia/shërbimi/sektori/drejtoria etj), VKM-ja përkatëse, niveli arsimor; specialisti i pagave bën zbadhjen e VKM-së (lidhjen/pikën e pagesës), bazuar në interpretimin e VKM-së përkatëse të cituar në akt.

ANEKS 3 - Shtim në strukturë për punonjës në Njësine Ditore të Shërbimeve Kirurgjikale, pranë PAI-t të Spitalit Polivalent, me 1 (një) Mjek Kirurg i Përgjithshëm”

<b>NJËSIA DITORE E SHËRBIMEVE KIRURGJIKALE</b>		
<b>POLI I ADMINISTRIMIT TË INTEGRUAR TË SPITALIT POLIVALENT</b>		
	<b>ISHTE</b>	<b>BËHET</b>
Përgjegjës Njësie	<b>1</b>	
Mjek kirurg	<b>0</b>	<b>1</b>
Total personel Njësia Ditore e Shërbimeve Kirurgjikale	<b>10</b>	<b>11</b>
<b>TOTAL PUNONJËS PAI I SPITALIT POLIVALENT</b>	<b>725</b>	<b>726</b>
<b>TOTAL PUNONJËS QSUT "NËNË TEREZA"</b>	<b>3048</b>	<b>3049</b>